

Eurosig sh.a

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara
për Vitin 2015

Përmbajtja

	Faqja
Raporti i Audituesit të Pavarur	1-3
Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar	4
Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital	6
Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve të Parasë	7
Shënimet e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara	8-56

Raporti i Audituesit të Pavarur

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar

	Shënimi	31 dhjetor 2015 (mijë lekë)	31 dhjetor 2014 (mijë lekë)
Aktivi			
Aktive afat-gjata materiale	7	448,810	162,693
Aktive afat-gjata jomateriale dhe emri i mirë	8	32,918	744
Depozita me afat	9	1,364,858	710,458
Pjesa e risiguresit në provigjionet e kontratave të sigurimit	10	154,277	24,183
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	11	547,953	296,476
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	12	477,402	181,816
Aktive të tjera	13	492,175	109,407
Mjete monetare dhe ekuivalente	14	93,897	21,967
Totali i aktivitet		3,612,290	1,507,744
Detyrime			
Provigjione për kontratat e sigurimit	15	2,837,696	842,739
Detyrime të qirasë financiare	16	11,645	-
Huate	17	43,430	11,783
Llogari të pagueshme për sigurimin, risigurimin dhe të tjera	18	369,383	87,573
Fondi i kompesimit		-	30,935
Detyrime tatimore aktuale		67,224	17,795
Totali i detyrimeve		3,329,378	990,825
Kapitali aksioner			
Kapitali aksioner	19	592,050	592,050
Rezerva rivlerësimi		-	-
Rezerva të tjera	19	10,334	10,334
Rezerve konvertimi	19	(6,746)	-
(Humbje)/ Fitimi i akumuluar		(312,726)	(85,465)
Totali i kapitalit aksioner		282,912	516,919
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner		3,612,290	1,507,744

Pasqyrat financiare të konsoliduara u miratuan nga bordi drejtues i Shoqërisë më 15 maj 2016, dhe janë firmosur në emër të tij nga:

Z. Xhevdet Kopani

Zj. Anila Ibro

Drejtore i Përgjithshëm

Drejtore i Departamentit Ekonomik

Shënimet shpjeguese nga faqa 8 deri në 56 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

	Shënimi	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Primet e shkruara bruto	20	3,007,943	1,348,215
Taksa mbi primet	20	(51,140)	-
Primet e ceduara në risigurim	20	(278,830)	(60,901)
Primet e shkruara neto	20	2,677,973	1,287,314
Ndryshimi bruto në primet e pafituara	20	(324,246)	(116,257)
Ndryshimi bruto në primet e pafituara dhe në RBNS, pjesa e risiguruesit	20	34,379	(11,323)
Primet e fituara neto	20	2,388,106	1,159,734
Të ardhura/(Shpenzime) nga tarifat dhe komisionet- neto	21	22,815	(374)
Të ardhura neto		2,410,921	1,159,360
Dëme dhe përfitime të shlyera		(704,719)	(246,899)
Ndryshimi në provigjionin e dëmeve		(300,141)	(81,250)
Dëmet dhe përfitimet e shlyera të polic-mbajtësve, neto	23	1,406,061	831,211
Kosto të marrjes në sigurim	24	(882,122)	(355,513)
Shpenzime administrative	25	(580,594)	(357,708)
Shpenzime të tjera operative	26	(78,350)	(10,437)
Provigjion për humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme nga sigurimi	11	(101,835)	(96,191)
		(236,840)	11,362
Të ardhura financiare dhe nga investimet	22	28,034	21,483
Shpenzime financiare dhe nga investimet		(4,436)	(1,522)
Fitime /(humbje) të tjera	27	(1,262)	2,448
(Humbje)/ fitimi para tatimit		(214,504)	33,711
Tatimi mbi fitimin	28	(12,757)	(21,476)
(Humbje)/ fitimi i vitit		(227,261)	12,295
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Diferenca kursi nga konvertimi		837	-
(Humbje)/ të ardhura të kombinuara gjithëpërfshirëse të vitit		(226,424)	12,295

Shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 56 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali aksioner	Rezerva e rivlerësimi t	Rezerve konvertimi	Rezerva të tjera	Fitime / (humbje) e mbartur	Totali
Gjëndja më 1 janar 2014	592,050	77,934	-	10,334	(97,760)	582,558
Transferimi i rezerves se rivlerësuar	-	(77,934)	-	-	-	(77,934)
Humbja e vitit	-	-	-	-	12,295	12,295
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	12,295	12,295
Gjëndja më 31 dhjetor 2014	592,050	-	-	10,334	(85,465)	516,919
Gjëndja më 1 janar 2015	592,050	-	-	10,334	(85,465)	516,919
Rezerve konvertimi	-	-	(6,746)	-	-	(6,746)
Transferimi i rezerves se rivlerësuar	-	-	-	-	-	-
Humbja e vitit	-	-	-	-	(227,260)	(227,260)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	(227,261)	(227,261)
Gjëndja më 31 dhjetor 2015	592,050	-	(6,746)	10,334	(312,726)	282,912

Shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 56 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve të Parasë

	Shënimi	2015	2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
(Humbja)/ fitimi para tatimit		(214,504)	33,771
Amortizimi i aktiveve afat-gjata	7,8	81,216	54,612
Humbje nga zhvleresimi	11	101,835	96,191
Të ardhura financiare	20	(28,034)	(21,483)
Shpenzime interesi		4,436	-
Rritje e pjesës së risiguruesit në provigjionet e kontratave të sigurimit		(22,832)	11,323
Rritje në llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe te tjera te arkëtueshme		(132,788)	(66,386)
Rritje në koston e shtyrë të marrjes në sigurim		(149,503)	(76,288)
(Rritja)/ rënie në aktive te tjera	12	18,601	(49,295)
Rritje në provigjionet e kontratave të sigurimit	13	456,295	197,507
Rritje në llogaritë e pagueshme për sigurimet, risigurimet dhe llogari të tjera	16	132,413	(4,432)
Rritje në provigjione te tjera		(30,935)	30,935
Diferenca konvertimi		6,746	-
Mjete monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		222,946	206,456
Interes i paguar		(3,182)	-
Tatimi i paguar mbi fitimin		(30,309)	(5,770)
Flukset monetare neto gjeneruar nga aktivitetet operative		189,455	200,686
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese			
Investime në shoqëri të kontrolluara		(287,515)	-
Blerje të aktiveve afat-gjata materiale	7	(51,996)	(87,696)
Shitje aktiveve afat-gjata		37,077	-
Renie/(Rritje) në depozitat me afat	9	137,808	(253,434)
Interesa të arkëtuar		35,558	21,483
Mjete monetare neto përdorur nga aktivitete investuese		(129,068)	(319,647)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese			
Marrje/(Shlyerje) të qirasë financiare	16	11,645	(495)
Pagesa për huatë e marra	17	(102)	(199)
Flukse monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet financuese		11,543	(694)
Rritja neto në mjetet monetare		71,930	(119,654)
Mjete monetare në fillim të vitit		21,967	141,621
Mjete monetare në fund të vitit	14	93,897	21,967

Shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 56 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Shënimet për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

1. Informacion i Përgjithshëm

Aktiviteti kryesor i Eurosig Sh.a - Shqipëri ("Shoqëria") dhe Shoqërisë së Kontrolluar Eurosig Sh.a – Kosovë (që së bashku përbëjnë Grupin) përfshin ofrimin e shërbimeve të sigurimit të jo-jetës për autoveturat, pasuritë e paluajtshme, shëndeti, transporti detar dhe tipe të tjera sigurimi.

Eurosig Sh.a. ("Shoqëria"), shoqëria mëmë e Grupit, është shoqëri aksionare e themeluar në Shqipëri me vendodhje në Tiranë, rruga Papa Gjon Pali II. Eurosig Sh.a. shoqëria mëmë e Grupit, është subjekt i ligjit 'Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime', të dates 22 maj 2014 ("Ligji mbi sigurimet").

Shoqëria e Kontrolluar Eurosig sh.a. në Kosovë është e themeluar si Shoqëri Sigurimesh në aktivitetin e Jo – Jetës që nga i vitit 2000 fillimisht me emrin Dardania dhe duke filluar nga dhjetori i vitit 2015 del në treg me emrin e ri Eurosig sh.a., tërësisht me kapital dhe aksionerë shqiptarë. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet në bazë e në zbatim të ligjeve të aplikueshme në Kosovë dhe akteve të tjera normative të dala në zbatim të tyre, si dhe mbikëqyrjet nga Banka Qendrore e Kosovës, Departamenti për Mbikqyrjen e Sigurimeve. Eurosig sh.a., si Shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, është e shtrirë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me 8 degë dhe mbi 62 zyra përfaqësimi.

Grupi operon në tregun e sigurimeve duke ofruar produkte sigurimi jo-jete në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të Kosovës.

Struktura e aksionerëve të Shoqërisë mëmë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
	%	%
Z. Kadri Morina	62.86	62.86
Shoqëria "Euro-Alba.Ea" Sh.p.k	32.7	32.7
Z. Xhevdet Morina	3.13	3.13
Z. Ylli Merkaj	1.31	1.31
Totali	100.00	100.00

Asnjë nga Shoqëritë e Grupit nuk është e listuar në ndonjë bursë.

Drejtimi i Shoqërisë

Drejtimi i shoqërisë mëme Eurosig Sh.a në Shqipëri gjatë vitit 2015 deri në datën e nënshkrimit të këtij raporti përbëhet nga:

Z. Xhevdet Kopani	Drejtore i Përgjithshëm
Zj. Anila Ibro	Drejtore i Departamentit Ekonomik
	Drejtore i Departamentit të Marrjes në Sigurim e Risigurim dhe Marrëdhënieve me jashtë
Zj. VeneraXhillari	Drejtore i Departamentit të Dëmeve
Z. Musa Huti	Drejtore i Drejtorisë së Financë – Kontabilitetit
Zj. Elda Shehu	Aktuar
Zj. Areta Çuko	

Bordi Mbikqyrës

Bordi mbikqyrës i Shoqërisë gjatë vitit 2015 deri në datën e nënshkrimit të këtij raporti përbëhet nga:

Z. Vasil Pilo	Kryetar
Z. Skender Madani	Anëtar
Z. Rexhep Mejdani	Anëtar

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit Eurosig Sh.a janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin 3. Me poshtë paraqiten parimet kryesore të politikave kontabel të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Shoqëria mëme Eurosig Sh.a përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF për Grupin Eurosig Sh.a, i cili përfshin Eurosig Sh.a në Shqipëri dhe Eurosig Sh.a. në Kosovë. Në pasqyrat financiare të konsoliduara, Shoqëritë e Kontrolluara, në të cilat Grupi kontrollon në mënyrë direkte ose jodirekte më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose zoteron të drejtën për të ushtruar kontroll mbi aktivitetet e tyre, konsolidohen plotësisht.

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në faqen zyrtare të Shoqërisë.

Më 31 Dhjetor 2015 humbjet e akumuluar të Grupit ishin në vlerën 312,726 mijë lekë (2014: 85,465 mijë lekë).

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat themelore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara janë të paraqitura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitur, nëse nuk shprehet ndryshe.

3.1 Ndryshimet në politikat kontabël

(i) Standardet e reja dhe ato të ndryshuara që janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2015

Disa standarde të reja dhe të rishikuara janë efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas 1 janarit 2015. Informacioni në lidhje me këto standarde është paraqitur si më poshtë.

Përshtatja e hershme e 'Skemës me përfitime të përcaktuara: Kontributet e punonjësve (Ndryshime në SNK 19)

Institucioni ka adoptuar më herët 'Skemën me përfitime të përcaktuara: Kontributet e punonjësve (Ndryshimet në SNK 19)'. Këto ndryshime janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Korrik 2014 dhe:

- qartësojë kërkesat e SNK 19 në lidhje me kontributet e punonjësve ose palëve të treta;
- prezantojnë një praktikë të dobishme kur kontributet janë të pavarura nga numri i viteve të shërbimit mund të trajtohen si një reduktim i kostove të shërbimit në periudhën në të cilën shërbimi është ofruar.

Shoqëria ka aplikuar këtë praktikë në politikat e saj kontabël. Ky trajtim është në përputhje me praktikat e mëparshme të shoqërisë para Ndryshimeve në SNK 19. Prandaj, aplikimi fillestar i ndryshimeve nuk ka efekt në pasqyrat financiare individuale të shoqërisë.

Ndryshimet e tjera në SNRF-të që u bënë të detyrueshme në fuqi në vitin 2015 nuk kanë ndikim material në rezultatet financiare të kompanisë apo pozicion . Prandaj, Grupi nuk ka bërë asnjë ndryshim në politikat e tij kontabël në vitin 2015

(ii) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e bëra në lidhje me standardet që nuk janë efektive dhe që nuk janë adoptuar më përpara nga ana e shoqërisë

Në datën e autorizimit të pasqyrave financiare të konsoliduara, disa standarde të reja, ndryshime e standardeve ekzistuese ishin publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) por që nuk janë bërë ende efektive dhe nuk kanë qenë të adoptuara më parë nga Grupi. Informacion në lidhje me ato standarde që priten të jenë të rëndësishme për pasqyrat financiare të Grupit është dhënë më poshtë.

Drejtimi i Grupit parashikon që të gjitha deklaratimet do të adoptohen në politikat kontabël të organizatës në momentin që këto deklarime do të behen efektive. Standardet, adoptimet dhe interpretimet e reja që janë nuk janë adoptuar apo listuar më poshtë nuk pritet që të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të shoqërisë.

SNRF 9 'Instrumentat Financiare' (2014)

Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) ka prezantuar së fundmi SNRF 9 "Instrumentet financiare" (2014), që përfaqëson përfundimin e projektit të tij për të zëvendësuar SNK 39 "Instrumentat Financiarë: Njohja dhe matja". Standardi i ri prezanton ndryshimet të mëdha të udhëzimeve të SNK 39 mbi klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe paraqet një model të ri 'humbje e prituri krediti' për zhvlerësimin e aktiveve financiare. SNRF 9 gjithashtu ofron udhëzime të reja për zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Drejtimi ka filluar të vlerësojë ndikimin e SNRF 9, por nuk është ende në gjendje për të dhënë informacion sasior. Në këtë fazë fushat kryesore të ndikimit të pritshëm janë si më poshtë:

- klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare të Grupit do të duhet të shqyrtohen në bazë të kriterëve të reja të cilat i konsideron flukset monetare kontraktuale të aktiveve dhe modelin e biznesit në të cilën ato janë menaxhuar
- do të jetë më e mundur për të matur investimet e kapitalit me kosto minus zhvlerësim dhe të gjitha këto investime do të maten me vlerën e drejtë. Ndryshimet në vlerën e drejtë do të paraqitet në fitim ose humbje, përveç rasteve kur Grupi bën një përcaktim të pakthyesëm për t'i paraqitur ato në të ardhura të tjera përmbledhëse.
- nëse Grupi zgjedh opsionin e vlerës së drejtë për pasivet financiare të caktuara, lëvizjet e vlerës së drejtë do të paraqitet në të ardhura të tjera të përgjithshme në masën që këto ndryshime kanë të bëjnë me rrezikun e kredisë së vetë Grupit.

SNRF 9 është në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018

SNRF 15 'Të ardhurat nga Kontratat me Klientët'

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të ardhurave, duke zëvendësuar SNK 18 'Të ardhurat', SNK 11 "Kontratat e ndërtimit", dhe disa Interpretimet të tjera në lidhje më të ardhurat. Standardi i ri krijon një model për njohjen e të ardhurave të bazuar në kontroll dhe jep udhëzime shtesë në shumë fusha që nuk mbulohen në detaje nga SNRF-të ekzistuese, duke përfshirë se si të trajtohen marrëveshjet me detyrimet e shumta të performancës, çmimet ndryshueshme, të drejtat e rimbursimit të klientëve, opsionin për riblerje nga furnizuesi, dhe të tjera kompleksitete të zakonshme.

SNRF 15 është efektive për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 janar 2018. Drejtimi i Grupit nuk ka vlerësuar ende ndikimin e SNRF 15 mbi këto pasqyra financiare.

Ndryshime në SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta

Këto ndryshime ofrojnë udhëzime mbi kontabilizimin për blerjen e interesave në operacionet e përbashkëta të cilat përbëjnë një biznes. Ndryshimet kërkojnë që të gjitha transaksionet e tilla të kontabilizohen duke përdorur parimet e kontabilitetit të kombinimit të bizneseve sipas SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit" dhe SNRF-të e tjera, përveç kur ato parime janë në kundërshtim me SNRF 11. Blerjet e interesave në sipërmarrjet e përbashkëta nuk ndikohen nga ky udhëzim të ri.

Grupi nuk ka bërë deri më sot ndonjë investim në një marrëveshje të përbashkët, në të cilën Grupi të ketë të drejta për një pjesë të aktiveve neto të marrëveshjes në vend të të drejtave të drejtpërdrejta mbi aktivet dhe detyrimet. Prandaj, në qoftë se adoptohen sot, këto ndryshime nuk do të kenë

ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare. Ndryshimet janë efektive për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janar 2016.

3.2 Baza për konsolidimin

Pasqyrat financiare të Grupit konsolidojnë ato të shoqërisë mëmë dhe të shoqërisë së kontrolluar të saj më 31 dhjetor 2015. Shoqëria e Kontrolluar ka një datë raportimi më 31 dhjetor 2015.

Të gjitha transaksionet dhe balancat ndërmjet të shoqërive të Grupit janë eliminuar në konsolidim, duke përfshirë fitimet e parealizuar dhe humbjet nga transaksionet në ndërmjet shoqërive të Grupit. Në rastet kur humbjet e parealizuar në shitjet e aseteve brenda grupit janë stornuar në konsolidim, aktivi është testuar edhe për zhvlerësim nga prespektiva e grupit. Shumat e raportuara në pasqyrat financiare të Shoqërive të Kontrolluara janë përshtatur aty ku është e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me politikën kontabël të miratuar nga Grupi.

Fitimi ose humbja dhe të ardhura të tjera përmbledhëse e Shoqërive të Kontrolluara të blera apo të shitura gjatë vitit njihen nga data efektive e blerjes, ose deri në datën efektive të shitjes, sipas rastit.

Grupi i atribuon të ardhurat totale gjithëpërfshirëse apo humbjen e filialeve ndërmjet pronarëve të Shoqërisë mëmë dhe interesave jo-kontrolluese në bazë të interesave të tyre përkatëse pronësore.

3.3 Kombinimet e biznesit

Grupi aplikon metodën e blerjes në kontabilitetin për kombinimet e biznesit. Pagesat e transferuara nga Grupi për të marrë kontrollin e një Shoqërie të Kontrolluar llogariten si shuma e vlerës së drejtë në datën blerjes efektive të aktive të transferuar, detyrimeve të lindura dhe interesat e kapitalit të emetuara nga Grupi, si dhe vlerën e drejtë të çdo aktivi ose detyrimi të kushtezuar të rregulluar me marrëveshje. Kostot e blerjes njihen në rezulatin e periudhës kur ndodhin. Aktivitetet e blera dhe detyrimet e përlogaritura maten në përgjithësi me vlerën e tyre të drejtë në datën e blerjes efektive.

3.4 Monedha të Huaja

Transaksionet në monedhë të huaj janë përkthyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e ditës në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet të shprehura në valutë të huaj në datën e raportimit janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në atë datë.

Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të emetuara në monedhë të huaj që janë të matur me vlerën e drejtë janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Diferenca nga kurset e këmbimit të ndodhura gjatë përkthimit njihen në fitim ose humbje.

Kurset zyrtare të këmbimit të përdorura për monedhat e huaja kryesore në 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit janë paraqitur në Lekë Shqiptar ("Lekë"), e cila është edhe monedha funksionale. Shumat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt (përveç rasteve kur është shprehur ndryshe).

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Dollari Amerikan (USD)	125.79	115.23
Njësia monetare e Bashkimit European (EUR)	137.28	140.14

3.4.1 Operacionet e huaja

Në pasqyrat financiare të Grupit, të gjitha aktivet, pasivet dhe transaksionet e subjekteve të Grupit me një monedhë funksionale të ndryshme nga Lekë janë përkthyer në Lekë në konsolidim. Monedha funksionale e Shoqërive në Grup ka mbetur e pandryshuar gjatë periudhës raportuese.

Në konsolidim, aktivet dhe pasivet janë përkthyer në lekë me kursin e mbylljes në datën e raportimit. Emri i mirë dhe rregullimet e vlerës së drejtë që lindin nga blerja e një njësie ekonomike të huaj janë trajtuar si aktive dhe pasive të njësisë ekonomike të huaj dhe janë përkthyer në lekë me kursin e mbylljes. Të ardhurat dhe shpenzimet janë përkthyer në lekë me kursin mesatar gjatë periudhës së raportimit. Diferencat e këmbimit janë debituar ose kredituar në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe janë njohur në rezervën e konvertimit në kapitalin neto. Diferencat kumulative të lindura gjatë shitjes së një shoqërie të kontrolluar të njohura në kapital riklasifikohen në fitimin ose humbjen e periudhës dhe njihen si pjesë e fitimit ose humbjes neto nga shitja.

3.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet në lidhje me to bazohen në eksperiencën historike dhe disa faktorë të tjerë të cilët besohet se janë të arsyeshme sipas rrethanave, si dhe me informacionin e disponueshëm në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara, rezultati i të cilave formon bazën e kryerjes së gjykimeve mbi vlerat e mbetura të aktiveve dhe detyrimeve të cilat nuk janë evidente nga burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet mbështetëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë të mëvonshme që ndikohet.

Gjykimet e kryera nga drejtimi në zbatimin e SNRF-ve me një efekt të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të konsoliduara dhe vlerësimet me risk të lartë në lidhje me sisteme materiale në të ardhmen paraqiten në shënimin shpjegues 4.

3.6 Emri i mirë

Emri i mirë përfaqëson përfitimet ekonomike në të ardhmen që rrjedhin nga një kombinim biznesi që nuk janë identifikuar individualisht dhe të njihen veçmas. Emri i mirë mbahet me kosto minus humbjet nga rënia në vlerë të akumuluar.

3.7 Aktivet Afatgjata Materiale

(iii) Njohja dhe matja

Aktivet afat-gjata materiale janë aktive të trupëzuara të cilat mbahen për përdorim në ofrimin e shërbimeve ose për qëllime administrative.

Zërat e aktiveve afat-gjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga zhvlerësimi. Kostoja historike përfshin shpenzime që lidhen nëmënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e këtyre elementeve.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shumat e marra me vlerën e mbetur, dhe duke përfshirë diferencën në pasqyrën e konsoliduar gjithëpërfshirëse të të ardhurave në zërin 'Fitime/(humbje) të tjera'.

(iv) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën e mbetur të zërit përkatës nëse është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin në fjalë do të merren nga Grupi dhe kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen në të ardhura ose shpenzime.

(v) Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime me metodën lineare mbi jetën e dobishme të aktivitetit për ndërtesat, kompjuterat, furniturat dhe pajisje edhe mjetet e transportit. Aktivitetet e marra me qira amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis periudhës së qiramarrjes dhe jetës së tyre të dobishme. Toka nuk amortizohet.

Vlera e rikuperueshme dhe jetët e dobishme rishikohen, dhe nëse është e nevojshme bëhen rregullimet përkatëse, në çdo datë bilanci.

Normat e amortizimit janë si më poshtë:

	2015	2014
Ndërtesa	2%-5%	5%
Kompjuterat	20%-33%	20%
Furnitura dhe pajisje	20%-33%	20%
Mjete transporti	12%-33%	20%
Përmirësime të ambjenteve të marra me qira	10%	10%

Kompjuterat, mobiljet dhe pajisjet janë grupuar në kategorinë instalime të përgjithshme, mobilje dhe pajisje të skedulit të lëvizjeve të aktiveve afatgjata materiale në shënimin shpjegues 6.

3.8 Aktivët afat-gjata jomateriale

Aktivët afat-gjata jomateriale që janë blerë nga Grupi, të cilat kanë një jetë të dobishme të kufizuar, vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimet e akumuluar. Norma e amortizimit është 10%-20% bazuar në koston e aktivitetit.

Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse shpenzimi rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin me të cilin ka të bëjë shpenzimi. Të gjitha shpenzimet, duke përfshirë shpenzime për emrin e mirë të gjeneruar nga Grupi apo markat, njihen në të ardhura ose shpenzime kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e konsoliduar gjithëpërfshirëse të të ardhurave bazuar në vlerën e mbetur duke përdorur normat fiskale për amortizimin e aktiveve të patrupëzuara, një muaj pas blerjes së aktivitetit.

Jeta e dobishme e aktiveve rishikohet, dhe bëhen rregullimet e nevojshme, në çdo datë bilanci. Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shitjet me vlerën e mbetur dhe diferencat përfshihen në pasqyrën e konsoliduar gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

Instrumentet financiarë

Grupi klasifikon instrumentet financiarë të saj sipas kategorive të mëposhtme në kredi dhe të tjera të arkëtueshme dhe aktive financiarë të mbajtur deri në maturim dhe aktive financiare të vlefshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin aktivet dhe detyrimet financiare janë blerë. Drejtimi përcakton klasifikimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare në njohjen fillestare dhe kur është nevojshme ri-vlerëson këtë përcaktim në çdo datë raportimi.

Kredi dhe të tjera të arkëtueshme

Kredi dhe të tjera të arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në tregje aktive përveç atyre aktiveve që Grupi synon ti shesë brenda një periudhe afatshkurtër ose i ka përcaktuar si aktive me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje. Kreditë dhe të drejtat e tjera njihen në fillim me vlerë të drejtë dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provigjionin për zhvlerësim. Provigjioni për zhvlerësimin e kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme krijohet kur ka një evidencë objektive që Grupi nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare. Të drejtat e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit që vijnë nga mbajtësit e policave të sigurimit gjithashtu klasifikohen në këtë kategori dhe rishikohen për zhvlerësim si pjesë e rishikimit përzhvlerësim të kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme.

Investime financiare të mbajtura deri në maturim

Investime financiare të mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme përveç atyre që përmbushin përkufizimin e kredive dhe të tjera të arkëtueshme dhe për të cilat Grupi ka qëllimin dhe mundësinë për ti mbajtur ato deri në maturim. Këto aktive njihen në fillim me vlerë të drejtë dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provigjionin për zhvlerësim, nëse ka. Një provigjion për zhvlerësimin e instrumenteve të borxhit të mbajtur deri në maturim krijohet nëse ka një evidencë objektive që Grupi nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare. Investime financiare të mbajtura deri në maturim përfshijnë bono thesari të emetuara nga Banka e Shqipërisë.

Njohja dhe çregjistrimi

Blerjet dhe shitjet e investimeve financiare njihen në datën e tregtimit e cila është data kur Grupi angazhohet të blejë apo të shesë instrumentin. Aktivet financiare njihen në fillim me vlerë të drejtë plus, kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e tyre në rastin e të gjithë aktiveve financiare që nuk mbahen me vlerë të drejtëpërmes fitimit ose humbjes. Aktivet financiare të mbajtura me vlerë të drejtëpërmes fitimit ose humbjes njihen fillimisht me vlerë të drejtë, dhe kostot e transaksionit njihen në të ardhura ose shpenzime.

Aktivitetet financiare regjistrohen kur të drejtat kontraktuale për arkëtime nga instrumentet financiare kanë skaduar ose janë transferuar dhe kur Grupi transferon të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë.

Matja e mëpasshme

Aktivitetet financiare të vlefshme për shitje dhe aktivitetet financiare me vlerë të drejtëpërmes fitimit ose humbjes mbahen me vlerë të drejte. Kreditë dhe të drejtat e tjera të arkëtueshme dhe aktivitetet e tjera të mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kompesimi i instrumenteve financiare

Aktivitetet dhe detyrimet financiare raportohen të kompesuara në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë ligjërishme e zbatueshme për të netuar shumat e njohura dhe ka një qëllim për t'i mbajtur ato mbi bazë neto, ose të njohësh aktivin dhe të shlyesh detyrimin në të njëjtën kohë.

Investime në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë janë instrumente borxhi për të cilat Grupi ka qëllimin dhe aftësinë që të mbaje deri në maturim dhe të klasifikojë si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet, të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktuara dhe të cilat mbahen deri në maturim maten në vijim me koston e amortizuar minus provizionin për zhvlerësim. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë në konsideratë çdo zbritje ose prim në blerje.

Instrumente kapitali

Instrumentet e kapitalit janë aktive financiare të cilat nuk kanë një çmim tregu në një treg aktiv dhe vlera e drejte e tyre nuk mund të matet në mënyrë të besueshme prandaj maten me kosto.

Depozita me afat

Depozitat me afat janë klasifikuar si kredi dhe të drejta dhe mbahen me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

Të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe aktive të tjera

Llogaritë e arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të arkëtueshme të tjera paraqiten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

Llogaritë e pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të pagueshme të tjera njihen në fillim me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar.

Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre

Për qëllimin e përgatitjes së pasqyrës së konsoliduar të pozicionit financiar dhe pasqyrës së konsoliduar të flukseve të parasë, mjetet monetare përfshijnë arkën dhe gjendjet e llogarive bankare me maturitet më pak se 3 muaj dhe pa risk të rëndësishëm të ndryshimit në vlerë.

Humbjet nga zhvlerësimi

Në çdo date të pasqyrës së konsoliduar të pozicionit financiar, Grupi vlerëson nëse ka prova objektive që aktivet financiare ose një grup i aktiveve financiare është zhvlerësuar. Një aktiv financiar ose grup aktivesh financiare zhvlerësohet dhe humbjet nga zhvlerësimi njihen vetëm nëse ekzistojnë prova objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të një aktivi (një 'ngjarje humbje') dhe ngjarja e humbjes (ose ngjarjet) ka ndikim në flukset e ardhshme të vlerësuara të aktivit financiar ose të një grupi aktivesh financiare që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Dëshmi objektive që një aktiv financiar ose grup aktivesh është zhvlerësuar përfshin të dhëna të vëzhgueshme që vijnë në vëmendjen e Grupit në lidhje me ngjarjet e mëposhtme:

- a) Vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose të debitorit;
- b) Shkelja e kontratës, si vonesa në pagesa e penalitete;
- c) Mundësia që emetuesi ose debitori do të hyjë në proces falimentimi ose riorganizime të tjera financiare;
- d) Zhdukja e një tregu aktiv për aktivin financiar për shkak të vështirësive financiare, ose
- e) Të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare nga një grup i aktiveve financiare që nga njohja fillestare e tyre, megjithëse rënia ende nuk mund të identifikohet specifikisht me një aktiv financiar të Grupit, duke përfshirë:
 - Ndryshimet jo të favorshme në statusin e pagesës së emetuesit ose të debitorit në Grup, ose
 - Kushte ekonomike kombëtare apo lokale ekonomike që lidhen me mos pagesën e aktivit të Grupit.

Ne fillim, Grupi konsideron nëse ekzistojnë evidenca objektive individuale të zhvlerësimit për aktivet financiare dhe janë individualisht të konsiderueshme. Nëse Grupi përcakton se nuk ka evidenca objektive të zhvlerësimit për një aktiv financiar të testuar individualisht, i konsiderueshëm apo jo, e bashkon aktivin në një grup aktivesh financiare me rrezik krediti të njëjte dhe në mënyrë kolektive i teston për zhvlerësim. Aktivet që janë të testuara në mënyrë individuale dhe për të cilat një humbje nga zhvlerësimi ekziston ose vazhdon të njihet nuk bashkohen me aktivet e tjera që testohen në mënyrë kolektive.

Nëse ekziston evidencë objektive që një humbje nga zhvlerësimi është krijuar për huatë dhe të arkëtueshmet ose nga aktivet financiare të mbajtura deri në maturitet që mbahen me kosto të amortizuar, shuma e humbjes matet si diferencë midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuara (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë që kanë ndodhur) të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar. Vlera kontabël e aktivit zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie rezerve, dhe shuma e zhvlerësimit njihet në fitim ose humbje.

Nëse një investim i mbajtur deri në maturim ose një hua ka një normë të ndryshueshme të interesit, norma e skontimit për matjen e zhvlerësimit është norma aktuale efektive e interesit e përcaktuar sipas kontratës.

Si praktikë e njohur, Grupi mund të masë zhvlerësimin e një instrumenti financiar në bazë të vlerës së drejtë duke përdorur një çmim të vëzhguar të tregut.

Për qëllim të testimit kolektiv për zhvlerësim, aktivet financiare grupohen sipas karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kreditit (p.sh., në bazë të procesit të vlerësimit të Grupit që konsideron llojin e aktivitetit, industrinë, pozicionin gjeografik, statusin e pagesave, dhe faktorë të tjerë të lidhur).

Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme për grupe të tilla aktivesh duke qenë tregues i aftësisë së emetuesit për të paguar të gjitha shumat sipas kushteve kontraktuale të instrumentit të borxhit në vlerësim.

Në qoftë se në një periudhë të mëvonshme, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me ngjarje që ndodhin pasi zhvlerësimi ishte njohur (të tilla si përmirësimi i indeksit të kreditit), humbja e njohur më parë nga zhvlerësimi ndryshohet duke rregulluar llogarinë e rezervës. Shuma e ndryshimit njihet në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Qiratë

Përcaktimi nëse një marrëveshje është apo përmban një qira bazohet në thelbin ekonomik të marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi apo i disa aktiveve të veçanta dhe marrëveshja kalon të drejtën e përdorimit të aktivitetit.

Qiratë financiare të cilat transferojnë të gjitha rreziqet dhe përfitimet si pasojë e pronësisë së aktivitetit të marrë me qira, kapitalizohen në fillim të qirasë me vlerën e drejtë të pronës që merret me qira ose, kur është më e vogël, me vlerën aktuale të pagesave minimale të qirasë dhe përfshihen në aktive afatgjata materiale me detyrimin përkatës ndaj qiradhënësit të përfshirë në detyrime të qirasë financiare. Pagesat e qirasë ndahen midis shpenzimit financiar dhe reduktimit të detyrimit. Shpenzimet financiare regjistrohen në 'Shpenzime të tjera operative'.

Aktivitetet e kapitalizuara amortizohen përgjatë më të shkurtrës midis jetës së tyre të dobishme dhe afatit të qirasë në rast se Shoqëria/Grupi nuk përfiton pronësinë ligjore të aktivitetit në fund të periudhës së qirasë.

Pagesat e qirasë së zakonshme njihen në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar. Qiraja e pagueshme kontabilizohet në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë dhe përfshihet në 'Shpenzime të tjera operative'. Kur një qira e zakonshme përfundon para afatit të përcaktuar, çdo pagesë që është e detyrueshme të bëhet qiradhënësit në formë penaliteti njihet si shpenzim në periudhën kur përfundimi ndodh.

Përfitimet e punonjësve

Përfitimet afat-skurtra

Grupi paguan për llogari të punonjësve të saj sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të llogaritura mbi pagën bruto, ashtu si edhe tatimin mbi të ardhurat personale të llogaritur gjithashtu mbi pagën bruto. Kontributet e mësipërme paguhen nga Grupi në një fond të administruar nga shteti, në përputhje me normat e përcaktuara me ligj gjatë vitit. Për më tepër, dietat për ushqim dhe transport dhe bonuset për pushime paguhen në përputhje me legjislacionin vendas. Këto shpenzime janë regjistruar në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave në periudhën kur shpenzimet e pagave kanë ndodhur.

Detyrimet për kontributet në planet e përcaktuara të kontributeve shoqërore njihen si shpenzim në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave kur ato ndodhin.

Tatimi mbi të ardhurat

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Shpenzimi për tatimin mbi fitimin njihet në pasqyrën e konsoliduar gjithëpërfshirëse të të ardhurave përveç rastit kur ky shpenzim lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejtë në pasqyrën e konsoliduar të lëvizjeve në kapital, rast në të cilin shpenzimi njihet në këtë pasqyrë.

Tatimi aktual është tatimi që pritet për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm gjatë vitit, duke përdorur normat tatimore efektive në datën e raportimit apo ato të hyra në fuqi më vonë, dhe çdo sistemim ndaj tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e detyrimit, duke krijuar provigjion për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të mbetura për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi në datën e raportimit apo që do të hyjë më vonë në fuqi.

Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme dhe aktivet tatimore të shtyra njihen vetëm nëse është e mundur që në të ardhmen do të ketë përfitime fiskale kundrejt të cilave do të mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra reduktohen kur nuk ka mundësi që përfitimet e lidhura tatimore do të realizohen.

Provigjionet

Provigjionet njihen kur si rezultat i një ngjarjeje të shkuar Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv aktual i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të kërkojnë flukse të ardhshme monetare për shlyerjen e detyrimit. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të vlerësuar duke përdorur një normë (para tatimi) që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit.

Kapitali aksioner

Kapitali aksioner (aksione të zakonshme)

Kapitali aksioner përbëhet nga vlera nominale e aksioneve të zakonshme të klasifikuara si kapital dhe të nominuara në Lekë.

Dividendë

Dividendët për kapitalin e zakonshëm aksioner njihen si detyrim në periudhën në të cilën ato deklarohen.

Rezerva ligjore

Rezerva ligjore përfaqëson përvetësimet nga fitimi i pashpërndare në përputhje me ligjet vendase (bazuar në kontabilitetin ligjor). Grupi nuk ka krijuar një rezerve të tilla në datën e raportimit.

Rezerva rivlerësimi

Grupi njer në kapital shtesën e shumës së rivlerësuar të aktiveve afat-gjata materiale.

Rezerva të tjera

Rezerva të tjera konsistojnë në rezerva të krijuara nga shoqëria mëmë Eurosig Sh.a në Shqipëri në bazë të Ligjit 9267 datë 29 korrik 2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” i ndryshuar me Ligjin 9338 datë 16 dhjetor 2004 dhe Ligjin 9685 dt. 26 shkurt 2007, neni 93: ‘Shoqëria e sigurimit krijon dhe mban çdo vit financiar me burimet e veta rezervën e sigurisë në nivelin jo më pak se 1/3 e fitimit të vitit ushtrimor, nëse fitimi nuk përdoret për mbulimin e humbjeve të trashëguara nga vitet e mëparshme’.

Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël të aktiveve të Grupit rishikohen çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim.

Vlera e rikuperueshme e aktivit vlerësohet kur ka të dhëna të tilla. Për aktivet me jetë të dobishme të pakufizuar (në datën e raportimit Grupi nuk ka aktive të tilla) dhe për aktivet afat-gjata jomateriale që nuk janë ende të vlefshme për përdorim, vlera e rikuperueshme vlerësohet në çdo datë bilanci.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur a një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të flukseve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare të cilat janë të pavarura në mënyrë të konsiderueshme nga aktive apo grupe të tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me njësitë gjeneruese shpërndahen për të zvogëluar vlerën e mbetur të aktiveve në njësinë përkatëse (grupin me njësi) në mënyrë përpjesëtimore.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo njësie gjeneruese është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë pas zbritjes së kostove të shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritjeje (para tatimit) që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivit.

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për ekzistencën e treguesve të një rënie apo eliminimi të zhvlerësimit. Humbja e zhvlerësimit rimerret nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Humbja e zhvlerësimit rimerret deri në masën që vlera e mbetur e aktivit nuk tejkalon vlerën e mbetur që do të ishte përcaktuar, pas zbritjes së amortizimit, nëse nuk do të ishte njohur asnjë humbje zhvlerësimi.

Të ardhurat

Politikat kontabël në lidhje me njohjen e të ardhurave nga policat e sigurimeve përshkruhen në shënimin shpjegues 3.

Të ardhura nga tarifat dhe komisionet

Të ardhurat nga komisionet përfshijnë komisione për risiguruesin, të njohur me shlyerje të risiguruesit. Në përputhje me përjashtimin nga SNRF 4, komisionet e risigurimit vazhdojnë të njihen plotësisht në shlyerje me risiguruesin.

Shpenzimet

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative përbëhen nga shpenzimet për blerjet e policave dhe shpenzime administrative të tjera.

Shpenzime të marrjes në sigurim

Shpenzimet e marrjes në sigurim përfshijnë të gjitha kostot direkte të krijuara nga nënshkrimi i kontratave të sigurimit si komisioni i agjentëve dhe shpenzimet e reklamave dhe marketingut.

Shpenzimet e komisioneve njihen në bazë të kontabilitetit të të ardhurave dhe detyrimeve të konstatuara në përputhje me kriterin e njohjes së të ardhurave.

Kosto administrative

Kostot administrative përfshijnë shpenzimet për personelin, amortizimin e aktiveve afat-gjata, koston e energjisë dhe kosto të tjera. Kostot e tjera konsistojnë kryesisht në koston e mbledhjes së primeve, kostot e përfundimit të policave, kosto të manaxhimit të portofolit dhe kosto administrative për risigurimin.

Klasifikimi i kontratave

Produktet e Grupit klasifikohen që në fillim, për qëllime kontabël, si kontrata sigurimi. Një kontratë e cila është klasifikuar si kontratë sigurimi qëndron si e tillë deri sa të drejtat dhe detyrimet që lidhen me të kane mbaruar ose skaduar. Kontrata sigurimi klasifikohen kontratat nëpërmjet të cilave Grupi pranon risk të rëndësishëm sigurimi nga një palë tjetër (policmbajtësi) duke rënë dakord të kompensojë policmbajtësin apo përfitues të tjerë nëse një ngjarje e ardhme e pasigurtë (ngjarja e siguar) ndikon negativisht policmbajtësin apo përfituesit e tjerë.

Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të mundshme në të ardhmen në një apo më shumë faktorë si midis një norme specifike interesi, çmimi i një letre me vlerë, çmimi i një produkti/shërbimi, kursi i këmbimit, indeksi i çmimeve dhe normave, një klasifikim apo indeks kreditimi ose elementë të tjerë, të vlefshme në

rastin e një elementi jo-financiar që nuk është specifik për një nga palët në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar. Pasi një kontratë është klasifikuar si një kontratë sigurimi, ajo mbetet një kontratë sigurimi për pjesën e mbetur të jetës, edhe në qoftë se rreziku i sigurimit zvogëlohet ndjeshëm gjatë kësaj periudhe, përveç se të gjitha të drejtat dhe detyrimet mbarojnë ose skadojnë. Kontratat e investimeve megjithatë mund të riklasifikohen si kontrata sigurimi pas njohjes fillestare në qoftë se rreziku i sigurimit bëhet i rëndësishëm.

Primet

Primet e shkruara bruto përfshijnë primet mbi kontratat që bëhen efektive gjatë vitit, pavarësisht nëse lidhen plotësisht ose pjesërisht me një periudhë të mëvonshme kontabël.

Primet nuk përfshijnë tatimet dhe taksat e tjera të llogaritura mbi to.

Pjesa e fituar e primeve të arkëtuara, duke përfshirë marrëdhëniet e pa-mbyllura të biznesit, njihet si e ardhur. Primet fitohen nga data në të cilën merret përsipër rreziku, gjatë periudhës së sigurimit, në bazë modelit të rrezikut të shkruar.

Primet për risigurimin njihen si shpenzim në bazë të modelit të rrezikut të shërbimit të marrë të risigurimit në të njëjtën periudhë kontabël si primet për produktet përkatëse të sigurimit.

Provigjioni i primeve të pafituara

Provigjioni për primet e pafituara përfshin pjesën e primeve të shkruara bruto të cilat vlerësohen të fitohen në vitin apo vitet financiarë në vijim, të llogaritura sipas metodës përpjesëtimore kohore, dhe të rregulluar kur është e nevojshme, për të pasqyruar çdo variacion në materializimin e rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata. Provigjioni i primeve të pafituara për Kartonin Jeshil, TPL dhe për policen kufitare është llogaritur në bazë të primit të rrezikut sipas vendimit të Bordit të Autoritetit të Mbiqyrjes Financiare të lëshuar gjatë vitit 2015 dhe 2014.

Provigjionet e sigurimit të jo-jetës

Provigjioni përfaqëson koston e vlerësuar përfundimtare të shlyerjes së të gjitha dëmeve duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte të shlyerjes që lindin nga ngjarje që kanë ndodhur deri në datën e raportimit. Humbjet e papaguara dhe shpenzimet e sistemit të humbjeve përbëhen nga vlerësime për humbjet dhe provigjionet e raportuara në lidhje me humbjet e ndodhura por të pa raportuara.

Dëmet

Dëmet në sigurimin e jo-jetës

Dëmet e ndodhura kanë të bëjnë me dëme dhe shpenzime në lidhje me administrimin e tyre të paguara gjatë vitit financiar bashkë me lëvizjet në provigjionin e dëmeve pezull. Dëmet e paguara janë regjistruar në momentin e procesimit të dëmit dhe janë njohur (përcaktuar) si shuma që duhet të paguhet për të shlyer dëmin. Dëmeve të paguara ju shtohen dhe shpenzimeve për administrimin e dëmeve.

Dëmet pezull të bazuara në vlerësimet e ngjarjeve dhe metodave statistikore përfshijnë provigjionet për vlerësimin e Grupit në lidhje me koston përfundimtare të shlyerjes për të gjitha dëmet e ndodhura, por të papaguara në datën e raportimit, të raportuara ose jo, së bashku me shpenzimet përkatëse të jashtme ose të brendshme të administrimit dhe marzhin e përshtatshëm të kujdesit.

Dëmet pezull vlerësohen duke rishikuar dëmet individuale dhe duke krijuar një zbritje për dëmet e ndodhura por të pa-raportuara ende. Metoda e përlogaritjes shpjegohet në seksionin 5.1.

Rimarrjet e paracaktuara nga risigurimet, dhe vlerësimet e rimarrjeve, paraqiten të ndara si aktive. Risigurimet dhe rimarrjet e tjera vlerësohen në një mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve pezull.

Ndërkohë që manaxhimi konsideron se provigjionet bruto për dëme dhe rimarrjet përkatëse nga risigurimi paraqiten drejtë në bazë të informacionit të disponueshëm, detyrimi përfundimtar do të variojë si rezultat i informacionit të mëpasshëm dhe ngjarjeve që mund të rezultojnë në rregullime të rëndësishme ndaj shumave të provigjionuara. Rregullimet e shumave të provigjioneve të dëmeve të përcaktuara në vitet e mëparshme pasqyrohen në pasqyrat financiare për periudhën në të cilën bëhet rregullimi, dhe paraqiten veçmas nëse janë materiale. Metodatat e përdorura dhe vlerësimet e kryera rishikohen rregullisht.

Risigurimi

Shumat e rikuperueshme nga kontratat e risigurimit rishikohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Aktive të tilla supozohen të zhvlerësuara nëse ka të dhëna objektive si rezultat i një ngjarjeje që ka ndodhur pas njohjes së tij fillestare, se Grupi mund të mos rikuperojë të gjitha të drejtat dhe ngjarja ka ndikim të matshëm e të besueshëm mbi shumat që Grupi mund të arkëtojë nga risiguresi.

Grupi kryen risigurime në vijimësinë normale të veprimtarisë me qëllimin e kufizimit të humbjes së mundshme neto përmes diversifikimit të rreziqeve. Marrëveshjet e risigurimit nuk çlirojnë Grupin nga detyrimet direkte ndaj policmbajtësve të saj.

Primet e ceduara dhe përfitimet e rimbursuara paraqiten bruto në pasqyrën e konsoliduar gjithëpërfshirëse të të ardhurave dhe në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar.

Vetëm kontratat që japin të drejtën e një transferimi të rëndësishëm të një rreziku sigurimi njihen si kontrata risigurimi. Shumat e rikuperueshme sipas këtyre kontratave njihen në të njëjtin vit si dhe dëmi përkatës. Kontratat të cilat nuk transferojnë rrezik të rëndësishëm sigurimi (që është risigurimi financiar), regjistrohen duke përdorur metodën kontabël të depozitimit. Grupi nuk ka kontrata të tilla në datën e raportimit.

Aktivet e risigurimit përfshijnë shuma që shoqëritë e risigurimit i detyrohen Grupit për detyrimet e ceduara të sigurimit. Shumat e rikuperueshme nga risiguresit vlerësohen në mënyrë konsistente me provigjionin e dëmeve pezull apo dëmeve të shlyera që i përkasin policës së risiguruar. Aktivët e risiguruara përfshijnë shumat aktuale apo të vlerësuara të cilat, në bazë të marrëveshjeve kontraktuale të risigurimit, janë të rikuperueshme nga risiguresit duke iu referuar provigjioneve teknike. Aktivët e risigurimit të lidhura me provigjionet teknike krijohen duke u bazuar në termat e kontratës së risigurimit dhe vlerësohen mbi të njëjtën bazë si dhe detyrimet e risiguruara përkatëse.

Komisionet e risigurimit

Komisionet e risigurimit përfshijnë komisionet e arkëtuara apo të arkëtueshme nga risiguresit në bazë të kontratës së risigurimit.

4. Vlerësime dhe gjykime kontabël

Këto shënimeshpjeguese i shtohen shpjegimeve në lidhje me manaxhimin e rrezikut financiar (shënimi 30) dhe manaxhimin e rrezikut të sigurimit (shënimi 5).

Grupi kryen vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që kryhen në përgjithësi ndryshojnë nga rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe gjykimet të cilat mbartin rrezikun e krijimit të ndonjë sistemimi të rëndësishëm në vlerën e mbetur të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit financiar në vijim diskutohen më poshtë.

4.1 Burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimeve

Provigjionet për humbjet e kreditorëve

Aktivitet paraqiten me kosto të amortizuar dhe rishqyrtohen për zhvlerësim bazuar në përshkrimet e politikës kontabël në shënimin 3 (j), mbi zhvlerësimin e aktiveve financiare.

Komponenti individual në totalin e provigjioneve aplikohet ndaj dëmeve të vlerësuara individualisht për provigjion dhe bazohet në vlerësimet më të mira të manaxhimit mbi vlerën aktuale të flukseve monetare të pritshme për t'u arkëtuar. Në vlerësimin e këtyre flukseve monetare, manaxhimi kryen vlerësime të situatës financiare të palës përkatëse dhe vlerës së realizueshme neto të kolateralëve mbështetës të llogarive të arkëtueshme.

Vlerësimi i pasigurisë në lidhje me provigjionet

Vlerësimet më të rëndësishme në lidhje me pasqyrat e konsoliduara financiare të Grupit lidhen me provigjionet. Grupi zbaton parimin e kujdesit të arsyeshëm në lidhje me provigjionimin dhe aplikon rregulla dhe rregullore të përcaktuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë. Grupi punëson matematicienë në pozicionin e aktuarit.

Politika e Grupit është bërja e provigjionit për rrezikun e paskaduar që krijohet nga sigurimet e jo-jetës ku dëmet dhe shpenzimet administrative të cilat mund të lindin pas fundit të vitit financiar në lidhje me kontrata të lidhura para asaj date priten të tejkalojnë primet e pafiturar dhe atë të vlefshëm sipas këtyre kontratave. Drejtimi nuk mendon se njohja e këtyre provigjioneve është e përshtatshme në datën e raportimit.

Drejtimi është i besimit se niveli i rezervave teknike është i mjaftueshëm.

Manaxhimi i rrezikut të sigurimit paraqitet në detaje në shënimin 5, ndërkohë provigjionet e kontratave të sigurimit analizohen në shënimin 15.

Drejtimi i Grupit është i mendimit se nuk ka rreziqe të rëndësishme në lidhje me sa më sipër në datën e raportimit.

Kombinimet e Biznesit

Drejtimi përdor teknika vlerësimi, kur përcaktimin e vlerave të drejta të aktiveve dhe detyrimeve të ndryshme të blera në një kombinim biznesi. Në veçanti, vlera e drejtë e pagesave të kushtëzuara varet nga rezultati i shumë variablaeve përfshirë të reultatet e ardhshme të shoqërisë së blere.

Vlerësimi i Kontrollit

Grupi zotëron 100% të aksioneve të zakonshme dhe të drejtave të votimit në Eurosrig Sh.a. në Kosovë

Rrjedhimisht drejtimi ka arritur në përfundimin se ka të kontroll të plotë mbi Shoqërinë Eurosrig Sh.a në Kosovë. Drejtimi ka përcaktuar si date efektive të fitimit të kontrollit mbi Shoqërinë e Kontrolluar datën 31 mars 2015 (shënimi 6)

5. Rreziku i sigurimit dhe financiar

Gjykime të rëndësishme kontabël të bëra në zbatim të politikave kontabël të Grupit përfshijnë:

Manaxhimi i rrezikut të sigurimit

Grupi është ekspozuar ndaj rrezikut aktuarial dhe atij të marrjes në sigurim që krijohen nga gama e gjërë e produkteve të ofruara të jo-jetës (aksidente, shëndeti në udhëtim, mjete motorike, transport, pasuri, MTPL, sigurimi i kontratave dhe garancive, etj.).

Rreziku i sigurimit lidhet me pasigurinë e tregut të sigurimeve. Komponentët kryesorë të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Këto lidhen me përshtatshmërinë e niveleve të primeve dhe përshtatshmërinë e provigjioneve në lidhje me detyrimet e sigurimeve dhe kapitalit.

Rreziku i primit është i pranishëm kur polica emetohet para ndodhjes së çdo ngjarjeje të siguruar. Rreziku ka të bëjë me faktin që shpenzimet dhe humbjet që ndodhin mund të jenë më të larta se primi i marre. Rreziku i rezervës paraqet rrezikun që niveli absolut i rezervave teknike është i gabuar ose që dëmet e ndodhura do të ndryshojnë nga mesatarja statistikore.

Rreziku i marrjes në sigurim për jo-jetën përfshin edhe rrezikun e katastrofës, i cili përfshin ngjarjet e parregullta të cilat nuk janë mjaftueshmërisht të mbuluara nga primet dhe rezerva e rrezikut.

Manaxhimi i rrezikut

Grupi manaxhon rrezikun e sigurimit përmes kufijve të marrjes në sigurim, procedurave të aprovimit për transaksionet që përfshijnë produktet e reja apo tejkalojnë limitet e vendosura, çmimin, dizajnimin e produktit dhe manaxhimin e risigurimit.

Të gjitha kontratat e jo-jetës (përveç pasurisë dhe aksidenteve) janë me natyrë vjetore dhe marrësit në sigurim kanë të drejtë të ndryshojnë termat dhe kushtet e kontratës në rinovim.

Grupi risiguron një pjesë të rreziqeve që merr në sigurim për të kontrolluar ekspozimin e tij ndaj humbjeve dhe për të mbrojtur burimet kapitale. Grupi hyn në marrëveshje risigurimi përpjestimore ose jo për të reduktuar ekspozimin neto ndaj rreziqeve të veçanta në aksidente, pasuri, transport, mjetemotorike, MTPL. Risigurimi i ceduar përmban risk kredie dhe risigurimi që mund të rimerret raportohet pas zbritjes të zërave që njihen si të pa mbledhshëm.

Përqendrimi i rrezikut të sigurimit

Një aspekt kryesor i rrezikut të sigurimit me të cilin përballlet Grupi është shtrirja e përqendrimit të rrezikut të sigurimit, i cili përcakton shtrirjen e ndikimit në detyrimet e Grupit së një ose disa ngjarjeve të veçanta. Këto përqendrime mund të lindin nga një kontratë e vetme sigurimi ose nëpërmjet një numër kontratash të lidhura nga të cilat mund të lindin detyrime të rëndësishme. Një aspekt i rëndësishëm i përqendrimit të rrezikut të sigurimit është fakti që ai mund të lindë nga akumulimi i rreziqeve brenda një numri klasash të ndryshme sigurimi.

Përqendrimet e rreziqeve mund të lindin rrallë nga ngjarje shumë të rënda si shkatërrimet natyrore, në situata kur Grupi është e ekspozuar ndaj ndryshimeve të papritura në tendenca, për shembull, ndryshime të papritura në sjelljen e policmbajtësve; ose kur risqe të rëndësishme konfliktesh apo ligjore mund të sjellin një humbje të vetme të madhe, ose të kenë një efekt të shpërndarë në shumë kontrata.

Rreziqet e marra në sigurim nga Grupi janë të përqendruara në Shqipëri dhe në Kosovë.

Përqendrimi i rreziqeve të sigurimit para dhe pas risigurimit në lidhje me llojin e rrezikut të sigurimit të pranuar, duke iu referuar vlerës së mbetur të dëmeve dhe përfitimeve të ndodhura (risigurimi bruto dhe neto) që vijnë nga kontratat e sigurimit, përmbledhet më poshtë:

<i>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</i>	Dëmet e shlyera bruto	Pjesa e risiguresit	Dëmet e shlyera neto
	LEK'000	LEK'000	LEK'000
Motorike (MTPL)	313,528	-	313,528
Kufitare	721	-	721
Shëndeti në udhëtim	7,542	-	7,542
Motorike (kasko)	102,876	-	102,876
Karton jeshil	79,513	-	79,513
Zjarri dhe rreziqet shtesë	10,293	-	10,293
Të tjera vullnetare	497,325	307,079	190,246
Totali	1,011,798	307,079	704,719

<i>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</i>	Dëmet e shlyera bruto	Pjesa e risiguresit	Dëmet e shlyera neto
	LEK '000	LEK '000	LEK '000
Mjete motorike (MTPL)	125,931		125,931
Mjete motorike (kasko)	29,586		29,586
Kufitare	3,574		3,574
Pasuri	2,100		2,100
Karton jeshil	62,704		62,704
Shëndeti në udhëtim	22,160		22,160
Garanci oferte dhe kontrate	844		844
Totali	246,899		246,899

Drejtimi është i besimit se nuk ka përqendrim të rëndësishëm në ndonjë grup të caktuar policmbajtësish duke marrë parasysh kritere sociale, profesionale, moshe, ose kritere të tjera të ngjashme me këto.

- Mundësia më e madhe e humbjeve të rëndësishme për Grupin vjen nga ngjarjet katastrofike, si dëme nga stuhi, rrëshqitje, përmytje apo tërmete. Teknikat dhe supozimet që Grupi përdor për llogaritjen e këtyre rreziqeve janë si më poshtë:
- Matja e përqëndrimit gjeografik.
- Vlerësimi maksimal i humbjeve të mundshme.
- Risigurimi.

Supozimet kryesore që kanë efektin më të madh në aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e njohura të sigurimit

Provizioni bëhet në datën e raportimit për kostot përfundimtare të pritshme të shlyerjes për të gjitha dëmet e ndodhura në lidhje me ngjarje deri në atë datë, pavarësisht nëse janë të raportuara apo jo, bashkë me shpenzimet e administrimit të dëmeve, minus shumat e paguara.

Detyrimi për dëmet e raportuara por jo të paguara (RBNP) vlerësohet ndarazi rast pas rasti duke i dhënë rëndësinë e duhur shkaqeve të dëmit, informacionit të marrë nga vlerësuesit e humbjes dhe nga të dhënat historike të përmasave të dëmeve të ngjashme. Rezervat e rasteve rishqyrtohen rregullisht dhe përditësohen kur ka informacion të ri.

Vlerësimi i dëmeve të ndodhura por jo të raportuara (IBNR) është përgjithësisht subjekt i një shkalle më të lartë pasigurie sesa për dëmet të raportuara. Provizionet e IBNR janë kryesisht të vlerësuara nga aktuarët e Grupit duke përdorur teknika statistikore, përmes të cilave të dhënat historike përdoren në mënyrë që të bëhet një vlerësim i kostove përfundimtare të dëmeve.

Metoda bazë për vlerësimin e IBNR është metoda zinxhir, e cila përdor të dhëna historike për të vlerësuar pjesët e paguara dhe ato që kanë ndodhur në koston përfundimtare të dëmit. Metoda e përdorur varion nga viti i aksidentit që merret për bazë, produkti dhe zhvillimet historike të dëmeve.

Duke qenë se këto metoda përdorin informacion historik të zhvillimit të dëmeve ato supozojnë se modeli i zhvillimit historik të dëmeve do të ndodhë përsëri në të ardhmen. Ka disa arsye përse kjo gjë nuk është e thënë të ndodhë duke qenë se identifikimi i ngjarjes varet nga modifikimi i metodave. Arsye të tilla përfshijnë:

- tendencat ekonomike, ligjore, politike dhe sociale (që rezultojnë në nivele të ndryshme rritjeje nga ajo e pritshme);
- ndryshime përbërjen e kontratave të marra në sigurim;
- luhatje të rastësishme, duke përfshirë ndikimin e humbjeve të mëdha.

Provizionet për IBNR janë fillimisht të vlerësuara në nivel bruto dhe më pas kryhet një llogaritje e veçuar për të vlerësuar masën e mbulimeve të risigurimit.

Supozimet të cilat kanë efektin më të madh në matjen e detyrimit për sigurimin e jo-jetës janë si më poshtë:

Norma e dëmeve të pritshme

Normat e dëmeve të pritshme është norma e dëmeve të pritshme për të ndodhur ndaj primeve të fituara. Supozimet në lidhje me normat e dëmeve të pritshme për vitet më të fundit të aksidenteve, sipas produktit, kanë ndikimin më të madh në nivelin e provigjioneve.

Distanca kohore

Për produktet me distancë kohore midis ndodhjes së dëmeve, niveli i provigjioneve influencohet shumë nga vlerësimi i zhvillimit të dëmeve nga viti më i fundit i zhvillimit për të cilin të dhënat historike janë të vlefshme deri në shlyerjen më të fundit. Këta faktorë vlerësohen me kujdes bazuar në eksperiencë.

Skontimi

Provigjionet e jo-jetës nuk skontojnë.

Testimi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Detyrimet e sigurimeve llogariten duke përdorur supozime historike.

Testimi i mjaftueshmërisë së detyrimeve për sigurimin e jo-jetës është i kufizuar në pjesën e pafituar të kontratave ekzistuese. Ky testim kryhet duke krahasuar vlerën e pritshme të shpenzimeve të dëmeve kundrejt periudhës së pafituar të policave efektiv në datën e raportimit me shumën e primeve të pafituar në lidhje me këto polica pas zbritjes së kostove direkte. Flukset e pritshme monetare në lidhje me dëmet dhe shpenzimet vlerësohen duke iu referuar eksperiencës gjatë pjesës së skaduar të kontratës duke e rregulluar me humbjet e rëndësishme individuale të cilat nuk pritet të ndodhin.

Testimi kryhet në bazë portofoli. Nëse testi tregon se detyrimi është i mjaftueshëm, e gjithë diferenca njihet në të ardhura dhe shpenzime. Testimi i mjaftueshmërisë më 31 dhjetor 2015 tregon se detyrimi është i mjaftueshëm.

Ndjeshmëria e vlerës aktuale të fitimeve të ardhshme ndaj ndryshimeve në elementë të rëndësishëm

Faktorë që do të kishin ndikimin më të madh në detyrimet e sigurimeve në sigurimet e jo-jetës janë të lidhur me ndryshimet e tendencave të shpenzimeve për polica, ligjore, ekonomike dhe sociale. Drejtimi është i besimit se kuantifikimi i ndjeshmërisë të rezervave të jo-jetës ndaj elementëve të mësipërm nuk është praktik.

Kushtet e kontratave të sigurimeve që kanë ndikim material në shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë

Grupit ofron lloje të ndryshme të sigurimit të jo-jetës, kryesisht sigurimin e mjeteve motorike për detyrimet ndaj palëve të treta, aksidentet, shëndetin, pasurinë, sigurimin kasko, detyrimet e përgjithshme dhe sigurimin e mallrave në transport (kargo). Kontratat mund të nënshkruhen për një periudhë fikse një-vjeçare ose mund të jenë te papërcaktuara ne vijimësi duke i dhënë të drejtën njëerës palë apo tjetrës ta prishë kontratën sipas rastit. Grupi është gjithashtu e aftë të rikompensojë

rrezikun duke rregulluar primin në intervale kohe jo më të mëdha se një vit. Grupi mund të vendosë zbritje për mbulimin dhe të refuzojë dëme që mund të jenë mashtrime.

Dëmet e ardhshme të sigurimeve janë burimi kryesor i pasigurisë e cila ndikon shumën dhe kohën e flukseve të ardhshme të parasë.

Shuma e pagesës për një dëm të veçantë është e limituar nga shumat e siguruar, e përcaktuar në policën e sigurimit.

Një tjetër burim i rëndësishëm i pasigurisë vjen nga rregullimet ligjore të cilat i japin të drejtën mbajtësit të policës të reklamojë dëmet e tij para dekretit të kufizimit, e cila është efektive 3 vjet nga data kur mbajtësi i policës bëhet i vetëdijshëm për dëmin por jo më vonë se 5 vjet nga fillimi i vitit në vijimësi të vitit kur ngjarja ka ndodhur. Kjo anë është veçanërisht e rëndësishme në rastet e një pamundësie të përkohshme që rrjedh nga sigurimi i aksidentit dhe dëmtimeve personale nga sigurimi i detyrimeve ndaj palëve të treta, për shkak të vështirësisë së vlerësimit të periudhës ndërmjet ndodhjes së ngjarjes dhe konfirmimit të efekteve përhershme.

Karakteristikat e llojeve të veçanta të sigurimeve, nëse ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga veçoritë e përmendura më sipër, janë të përshkruara më poshtë.

Sigurimi i mjeteve motorike

Portofoli i mjeteve motorike përfshin si MTPL ashtu dhe kasko. Sigurimi MTPL mbulon si dëmtimet trupore dhe ato pasurore. Grupi nuk ofron sigurim për dëmet e shkaktuara jashtë vendit për personat e siguruar, sistemi i kartonit jeshil.

Dëmet e pasurisë në dëmet MTPL dhe kasko raportohen dhe shlyhen përgjithësisht brenda një kohe të shkurtër pas ngjarjes së aksidentit. Raportimi dhe pagesa për dëmtimet trupore nga ana tjetër kërkon një kohë më të gjatë për t'u finalizuar. Këto dëmtime janë më të vështira për t'u vlerësuar. Këto dëme mund të shlyhen në formën e një shume të vetme apo nëpërmjet shumave të përvitshme.

Shumat e dëmeve në lidhje me dëmtimet trupore dhe humbjet përkatëse të fitimit ndikohen nga praktikatat gjyqësore.

MTPL rregullohet me ligjin për sigurimin e përgjegjësisë nga mjetet motorike ndaj palëve të treta dhe nga detyrime të tjera ligjore për sigurimet. Tarifatat dhe shumat minimale të siguruar rregullohen me ligj. Policmbajtësit kanë të drejtën e bonuseve përveç rasteve të dëmeve për rinovimin e policës së tyre kur plotësohen kushtet.

Sigurimi kasko ka të bëjë me sigurim standard kundër dëmtimeve; pagesa e dëmit kufizohet nga shumat e siguruar.

Dëmet njihen normalisht direkt dhe mund të shlyhen pa vonesa.

Sigurimi i pasurisë

Sigurimi i pasurisë ndahet në linjat industriale dhe personale. Për linjat industriale, Grupi përdor teknikat e manaxhimit të rrezikut për identifikimin e rreziqeve dhe analizën e humbjeve si dhe bashkëpunon me risiguruesit. Sigurimi i pasurisë personale konsiston në sigurimin e ndërtesës dhe përmbajtjeve të saj.

Dëmet njihen normalisht direkt dhe mund të shlyhen pa vonesa.

Sigurimi i përgjegjësisë

Mbulon gjithë llojet e përgjegjësisë dhe përfshin përgjegjësinë e zhdëmtimeve tregtare dhe profesionale si dhe përgjegjësinë personale.

Ndërkohë që mbulimi i shumicës së përgjegjësisë të përgjithshme nënshkruhet në bazë të dëmit, disa mbulime sigurohen në bazë të ngjarjes.

Sigurimi i aksidenteve

Shitet tradicionalisht si skemë për grupe punonjësish ose si një shtesë ndaj produkteve MTPL.

Shëndeti në udhëtim

Mbulon gjithë dëmtimet dhe aksidentet e tjera personale gjatë udhëtimeve jashtë vendit.

6. Blerje e shoqërive të kontrolluara

Më 14 maj 2015, Eurosig Sh.a në Shqipëri përfundoi një marrëveshje për blerjen 100% të 100,000 aksioneve të Dardania Sh.a një kompani sigurimi që vepron në Republikën e Kosovës. Vlera nominale për aksion ishte 30 Euro. Çmimi i rënë dakord ndërmjet palëve ishte i barabartë me vlerën nominale të aksioneve të blerë ose 3 milion EUR (lekë 421,680 mijë). Sipas marrëveshjes së blerjes së aksioneve, çmimi i blerjes u pagua në dy këste prej 2,851 mijë euro transferuar më 16 mars 2015 dhe 149 mijë euro më 20 nëntor 2015. Banka qendrore e Kosovës ka miratuar blerjen e Dardania Sh.a më 3 prill 2015. Drejtimi ka përcaktuar si date efektive të fitimit të kontrollit mbi Shoqërinë e Kontrolluar datën 31 mars 2015. Në dhjetor 2015, Dardania Sh.a ndërroi emrin në Eurosig Sh.a.

Te dhenat mbi Investimin në shoqërinë e kontrolluar tregohen si me poshte:

Emri	Adresa	Aktiviteti Kryesor	% e pjesëmarrjes
Eurosig Sh.a	Rr. Suljman Vokshi Nr 4 Prishtine, Kosove	Shoqëri Sigurimesh	100%

2015

Vlera e drejtë e pagesës për blerjen e Shoqërisë së Kontrolluar

Shuma e paguar në mjete monetare	421,680
----------------------------------	---------

Shumat e njohura të aktiveve të identifikueshme neto më 31 mars 2015

Kapitali aksioner	1,499,862
(Humbje)/ Fitimi i akumuluar	(1,101,439)

Vlera neto e aktiveve të Shoqërisë së Kontrolluar më 31 mars 2015

Emri i mire në datën efektive të blerje	23,258
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(543)

Emri i mirë më 31 dhjetor 2015	22,715
	2015
Shuma e paguar në mjete monetare	421,680
Mjete monetare të fituara në blerjen e Shoqërisë së Kontrolluar	(134,165)
Flukse neto në blerjen e Shoqërisë së kontrolluar	287,515

7. Aktive afat-gjata materiale

	Ndertesa	Instalime, mobilje, pajisje	Makineri	Ndërtim në proces	Përmirësime të ambienteve të marra me qira	Totali
Kosto						
Gjendje më 1 janar 2014	-	238,517	69,031	88,852	93,878	490,278
Shtesa	-	43,576	36,188	13,664	7,932	101,360
Pakësimet	-	-	-	(102,516)	-	(102,516)
Gjendje më 31 dhjetor 2014	-	282,093	105,219	-	101,810	489,122
Gjendje më 1 janar 2015	-	282,093	105,219	-	101,810	489,122
Shtesa nga blerja e shoqërive të kontrolluara	317,542	11,081	20,284	-	-	348,907
Shtesa gjatë vitit	-	30,976	18,717	-	-	49,693
Pakësimet	(19,858)	-	(17,711)	-	492	(37,077)
Gjendje 31 dhjetor 2015	297,684	324,150	126,508	-	102,302	850,644
Amortizimi i akumuluar						
Gjendje më 1 janar 2014	-	(181,288)	(49,185)	-	(42,657)	(273,130)
Amortizimi i vitit	-	(35,099)	(8,401)	-	(9,798)	(53,298)
Gjendje më 31 dhjetor 2014	-	(216,387)	(57,586)	-	(52,455)	(326,428)
Gjendje më 1 janar 2015	-	(216,387)	(57,586)	-	(52,455)	(326,428)
Amortizimi i vitit	(5,430)	(40,420)	(19,669)	-	(10,189)	(75,708)
Diferenca kursi	97	85	120	-	-	302
Gjendje më 31 dhjetor 2015	(5,333)	(256,722)	(77,135)	-	(62,644)	(401,834)
Vlera e mbetur						
Më 31 dhjetor 2014	-	65,706	47,632	-	49,355	162,693
Më 31 dhjetor 2015	292,350	67,428	49,374	-	39,658	448,810

Grupi ka si aktive të lëna si kolateral toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje në vlerë prej 36,760,289 lekë (267,776 EUR).

8. Aktive afat-gjata jomateriale

	Emri i mirë	Programe kompjuterike	Total
Kosto			
Gjendje më 1 janar 2014	-	15,747	15,747
Shtesa	-	-	-
Gjendje më 31 dhjetor 2014	-	15,747	15,747
Gjendje më 1 janar 2015	-	15,747	15,747
Shtesa nga blerja e shoqerive te kontrolluara	-	12,579	12,579
Shtesa gjatë vitit	22,715	2,303	25,018
Gjendje më 31 dhjetor 2015	-	30,629	53,344
Amortizimi i akumuluar			
Gjendje më 1 janar 2014	-	(13,690)	(13,690)
Amortizimi i vitit	-	(1,314)	(1,314)
Gjendje më 31 dhjetor 2014	-	(15,004)	(15,004)
Gjendje më 1 janar 2015	-	(15,004)	(15,004)
Amortizimi i vitit	-	(5,508)	(5,508)
Diferenca kursi	-	86	86
Gjendje më 31 dhjetor 2015	-	(20,426)	(20,426)
Vlera e mbetur			
Më 31 dhjetor 2014	-	744	744
Më 31 dhjetor 2015	22,715	10,203	32,918

9. Depozita me afat

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Depozita me afat në banka	1,331,870	701,158
Interes i përlogaritur	32,988	9,300
Totali	1,364,858	710,458

Depozitat me afat në banka përbëhen nga depozita dhe interesi i maturuar përkatës. Depozitat janë me afat maturimi nga 1 muaj deri 1 vit, kanë norma fikse interesi dhe në bazë të detyrimeve ligjore janë të gjitha të depozituara në bankat shqiptare.

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Depozita me afat		
LEK	562,800	684,574
EUR	769,070	6,584
Interes i përlogaritur/(parapagime)	32,988	9,300
Totali	1,364,858	710,458

Normat e interesit nga depozitat paraqiten më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
LEK	1.5%-6.4%	1.8%-7%
EUR	1.4%-6.5%	0.4%-5.7%

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Tirana Bank Albania	19,332	99,332
Veneto Bank Albania	179,289	106,789
Union Bank Albania	60,680	60,680
Credins Bank Albania	55,617	55,629
First Investment Bank Albania	55,330	75,169
Alpha Bank Albania	32,011	45,745
Raiffeisen Bank ("RZB") Albania	18,000	139,000
Banka Kombetare Tregtare ("BKT") Albania	459,270	76,271
International Commercial Bank ("ICB") Albania	-	12,083
United Bank of Albania ("UBA") Albania	2,590	2,590
Societe Generale Albania	-	27,870
NLB Prishtina Kosova	205,330	-
BpB Kosova	5,663	-
TEB Kosova	91	-
IS Banka Kosova	194,938	-
Banka Ekonomike Kosova	1,531	-
Banka Qëndrore e Kosovës	42,199	-
Total	1,331,870	701,158

Bazuar në kërkesat e vendimit nr. 2, më datë 23 janar 2006, për aprovimin e rregullores “Mbi rregullimin dhe limitet e investimit të kapitalit të kompanive të sigurimit” të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Shoqëritë e sigurimit nuk u lejohej të investojnë në të njëjtën bankë lokale mbi 25% të kapitalit të tyre.

10. Pjesa e risiguruesit në provigjionet e kontratave të sigurimit

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Jo-jetë		
Pjesa e risiguruesit në provigjionet e primeve të pafituara	154,277	24,183
Totali	154,277	24,183

11. Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të drejta nga kontrata të sigurimit		
- nga polic-mbajtësit (bruto)	669,270	392,667
Minus: Fondi i provigjionit për humbjet kreditore	(121,317)	(96,191)
Totali	547,953	296,476

Llogaritë e arkëtueshme nga kontratat e sigurimit përbëhen kryesisht nga llogari të arkëtueshme nga drejtimi i degëve. Këto kanë të bëjnë me polica të shitura të cilat nuk janë arkëtuar nga Grupi deri më 31 dhjetor 2015.

Levizjet në fondin e provigjionit paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Gjendja me 1 janar	96,191	78,010
Shumat e fshira nga bilanci (të paarketueshme)	(96,191)	(78,010)
Humbjet nga zhvlerësimi	101,835	96,191
Gjendje me 31 dhjetor	101,835	96,191

Humbjet nga zhvlerësimi prej 101,835 mijë lekë janë llogaritur si total i humbjeve vjetore të Eurosig Sh.a në Shqipëri prej 86,800 mijë lekë me humbjet e përlllogaritura propocionlisht pas datës 31 mars të Shoqërisë së Kontrolluar Eurosig Sh.a në Kosovë prej 15,035 mijë lekë.

Gjate vitit 2015, Shoqëria mëmë Eurosig Sh.a në Shqipëri si rezultat i vlerësimit të arkëtueshmërisë së llogarive të arkëtueshme nga degët dhe agentët, vendosi të fshijë shumën prej 96,191 mijë lekë nga llogaritë e arkëtueshme të cilat ishin zhvlerësuar plotësisht përgjate vitit 2014.

12. Kosto të shtyra të marrjes në sigurim

Si pjesë e aktiviteteve të Grupit disa kosto janë të shtyra (kryesisht komisionet). Një analizë e kostove të shtyra është paraqitur në tabelën më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Ne 1 janar	181,816	105,529
Rritje në kostot të marra në sigurim	295,586	76,287
Me 31 Dhjetor	477,402	181,816

Rritja e kostove të shtyra nga viti paraardhës vjen si rezultat i rritjes në prime të nënshkruara dhe komisioneve përkatëse që përcaktohen si përqindje e primeve.

13. Aktive të tjera

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Inventari i policave	1,923	1,738
Parapagime	233,773	40,483
<i>Aktive financiare të tjera</i>		
Te arketueshme nga "Qendra Kardiale e Kosoves"	178,716	-
Debitor	31,675	43,291
Deme me padi regresi	20,718	23,895
Garanci për kartonin jeshil	25,369	-
Totali	492,175	109,407

Dëme me paditë e regresit lidhen me pagesa të kryera nga Grupi për të shlyer dëme të shkaktuara nga një palë e pasiguruar dhe që priten të arkëtohen si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore. Këto pagesa janë kryer në vijim të direktivave të Byrosë Shqiptare të Sigurimeve si dhe në përputhje me kuadrin rregullator përkatës. Këto padi janë në procese gjyqësore të nisura nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve dhe përfaqësuara në gjykatë nga vetë Shoqëria.

14. Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Arka		
LEK	26,525	89
EUR	10,102	14,079
USD	1,311	-
	37,938	14,168
Llogari rrjedhëse në banka		
LEK	2,859	5,660
EUR	52,987	1,823
USD	112	316
	55,958	7,799
Totali	93,897	21,967

15 Provigjione për kontratat e sigurimeve

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
